



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:271328

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05518059

**P.nr./..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit D..B.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 lidhur me par 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1962/23 të datës 15.12.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.02.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 20.02.2024 e lidhur në mesë të pandehurit D..B.. dhe të dëmtuarit F.. (N..) J.. nga P.. rr. V.. T.. nr..

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II-nr.1962/23 të datës 15.12.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit: **D..B..**, i atësisë S.. dhe amësisë Gj., i lindur me ..... në P., ku edhe jeton, rr "A.. J.." H--K-- nr-... me profesion punëtor, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. .... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon nr të telefonit ....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nen par 1.4 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 20.12.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1866/22 ndaj të pandehurit D..B.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 lidhur me par 1.4 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës 20.02.2024 pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit dhe të dëmtuarit gjykata ka marr aktvendim me të cilin e ka aprovuar propozimin e të pandehurit që kjo çështje penale të referohet ne procedurë te ndërmjetësimit.

Me datën 20.02.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit D..B.. dhe të dëmtuarit F.. (N..) J.. nga P.. rr. V.. T.. nr. .., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 20.02.2024 e lidhur në mesë të pandehurit D..B.. dhe të dëmtuarit F.. (N..) J...

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2022:271328, 28.03.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

Edona Berisha Kastrati

**Gj y q t a r i**

Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit.